



Në bazë të pikës 5 të nenit 26 të Ligjit për Arsimin e Lartë të Kosovës (Ligjit Nr. 04/L-037, të datës 29.08.2011), Udhëzimit Administrativ 01/2018, të datës 19.01.2018, Udhëzimit Administrativ 7/2018, të datës 23.05.2018, nenet 22, 37, 79, 80 dhe 81 të Statutit të Kolegjit ESLG-së, dhe Rregullores mbi Standardet për Përzgjedhje në Tituj Akademik të Mësimdhënësve në Arsimin e Lartë, Punonjësve Shkencor dhe Bashkëpunëtorëve Shkencor në Kolegjin ESLG, Senati i Kolegjit ESLG në mbledhjen e mbajtur më 16.02.2021 ka aprovuar raportin dhe propozimet e Komisionit Vlerësues dhe i ka rekomanduar Rektorit të Kolegjit ESLG të nxjerr:

V E N D I M

- I. **Dr.sc. Hazer Dana**, zgjedhet **Profesor Asistent** në fushën e studimit: Demografia dhe vendbanimet në Fakultetin e Menaxhimit të Patundshmërive të Kolegjit ESLG.
- II. Zgjedhja është bërë në tërësi sipas procedurës zgjedhore në pajtim me kushtet e parapara me Statutin dhe Rregulloren mbi Standardet për Përzgjedhje në Tituj Akademik të Mësimdhënësve në Arsimin e Lartë, Punonjësve Shkencor dhe Bashkëpunëtorëve Shkencor në Kolegjin ESLG, Ligjin për Arsimin e Lartë në Kosovë Nr. 04/L-037; Udhëzimin Administrativ 01/2018, datë 19.01.2018, dhe Udhëzimin Administrativ 7/2018, datë 23.05.2018.
- III. I zgjedhuri është i obliguar t'u përmbahet dispozitave të Statutit si dhe të pranojë angazhimet e tjera të caktuara nga Menaxhmenti, që përkojnë me kualifikimet profesionale-shkencore, dhe thirrjen akademike.
- IV. Zgjedhja në thirrjen akademike Profesor Asistent jepet për periudhën 4 vjeçare.
- V. Çështja e normës së angazhimit, pagesës së të ardhurave personale dhe çështjet e tjera rregullohen sipas Kontratës individuale që Institucioni e ka nënshkruar me të emëruarin.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi më 17.02.2021.

A r s y e t i m i

Kolegji ESLG ka bërë thirrje të hapur për të gjithë stafin akademik, për të aplikuar për thirrjen Profesor Asistent dhe Ligjërues. Pas pranimit të të dhënave nga njësitë akademike, Komisioni Vlerësues ka trajtuar dosjen e secilit kandidat bazuar në kriteret e parashikuara me nenin 24 të Rregullores mbi Standardet për Përzgjedhje në Tituj Akademik të Mësimdhënësve në Arsimin e Lartë, Punonjësve Shkencor dhe Bashkëpunëtorëve Shkencor në Kolegjin ESLG për përzgjedhje në titullin akademik Profesor Asistent.

Bazuar në dispozitat ligjore të theksuara më lart, Komisioni Vlerësues ka hartuar raportin me të gjeturat dhe të njëjtin e ka dërguar për miratim te Senati.

Senati në mbledhjen e mbajtur më 16.02.2021, ka trajtuar raportin në fjalë, e ka miratuar dhe të njëjtin e ka përcjellë te Rektori për vendim përfundimtar.

Bazuar në Raportin e Komisionit Vlerësues për thirrjet akademike, aprovimit nga Senati i Kolegjit ESLG, Rektori vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi mund të parashtrohet ankesë në afatin prej 15 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ankesa i drejtohet Komisionit të Ankesave të caktuar nga Senati në Kolegjin ESLG.

Vendimi i dorëzohet:

1. Të zgjedhurit;
2. Njesisë akademike;
3. Departamentit të Burimeve Njerëzore, dhe
4. Arkivit.

Rektori:
Prof. Asoc. Dr. Visar Hoxha

